



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1051 prot.

Tiranë, më 02. 07. 2019

V E N D I M

Nr. 83, Datë 02. 07. 2019

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 19, datë 05.03.2019, e shtetases A. Z., kundër Bashkisë Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të bindjeve politike*¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesja shpjegon se më datë 31.01.2019, me Urdhërin Nr. 5160, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, është emëruar në detyrën e Drejtorit të Qendrës Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”, Institucion në varësi të Bashkisë Tiranë. Në cilësinë e anëtares së Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet, ka marrë pjesë në protestën e zhvilluar më datë 16.02.2019. Më datë 19.02.2019, nga ana e punëdhënësit i është komunikuar Urdhëri nr. 8151, datë 18.02.2019, i Kryetarit të Bashkisë Tiranë, për shkarkimin nga detyra dhe zgjidhjen e kontratës individuale të punës.

Më datë 18.02.2019, dy ditë pas zhvillimit të protestës, në portalin Boldnews.al është publikuar artikulli me titull “*Ekskluzive/Lali Eri mbështet protestën e opozitës, zyrtarët e tij në protestë*”, me anë të të cilit komentohej se kryetari i Bashkisë Tiranë kishte mbështetur protestën kundër qeverisë duke sjellë si argument pjesëmarrje e punonjësve të Bashkisë

¹ Mbështetur në Kartën e Anëtarësisë Nr. 000007, ankuesja është anëtare e subjektit politik Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet. Gjithashtu mbështetur në informacionin e cituar në median e shkruar dhe atë vizive (Gazeta Panorama Onile, Boldnews, Dosja.al dhe 27.al), ku citohet se ankuesja si anëtare e subjektit politik Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet.

Tiranë, anëtarë të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet. Ndër të tjera në këtë artikull citohej se: *“...Në protestën masive të thirrur nga opozita më 16 shkurt, në ballë të një grupi të përfaqësuesve të PDIU-së ishte kryetari Shpëtim Idrizi, ndërsa më pas krahët e ngrohtë ia mbante nënkryetarja e Bashkisë Tiranë, K. M. dhe drejtori i tregjeve në kryeqytet S. H...”*. Gjithashtu, bashkë me artikullin janë publikuar edhe 5 foto, ku në njërin prej tyre shfaqet edhe ankuesja, A. Z.

Po më datë 18.02.2019, media Panorama Online, ka publikuar artikullin me titull *“‘Jam qytetare e lirë’, nënkryetarja e shkarkuar e Bashkisë reagon pas vendimit të Veliajt: E nderuar që...”*, në të ndër të tjera citohej se: *“Tjetër e shkarkuar është edhe A. Z. drejtor i qendrës komunitare ‘Gonxhe Bojaxhi’*”. Gjithashtu edhe media online dosja.al dhe 27.al, kanë cituar largimin e punonjësve të Bashkisë Tiranë të cilët janë larguar nga detyrat që mbanin në Bashkisë Tiranë, për shkak të pjesëmarrjes në protestën e datës 16.02.2019.

Sipas ankueses, pavarësisht faktit që më datë 18.02.2019 ajo ka ushtruar detyrën e saj gjatë të gjithë orarit zyrtar të punës, nuk është vënë në dijeni nga drejtuesit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Më datë 19.02.2019, si çdo ditë tjetër, është paraqitur në vendin e saj të punës, pranë Qendrës Komunitare “Gonxhe Bojaxhi” dhe rreth orës 10:00, është njoftuar me anë të telefonit se duhet të paraqitet pranë drejtorisë së personelit në Bashkinë Tiranë.

Në orën 10:30, ankuesja është paraqitur pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, ku ka marrë takim me K. L., e cila mban pozicionin e Drejtores së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Tiranë. Në takimin e zhvilluar është vënë në dijeni, se arsyeja e largimit nga puna lidhet me pjesëmarrjen e saj në protestën e datës 16.02.2019, si dhe i është vënë në dispozicion Urdhëri nr. 8151, datë 18.02.2019, për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu, ankuesja ka sqaruar se në të njëjtën datë dhe për të njëjtën arsye, janë larguar nga detyra Nënkryetarja e Bashkisë Tiranë, K. M., si dhe Drejtori i Tregjeve, S. H.

Përsa më lart, ankuesja pretendon se trajtimi i pabarabartë, diskriminues dhe largimi i saj nga puna është bërë për shkak të bindjeve politike dhe pjesëmarrjes në protestën e zhvilluar më datë 16.02.2019.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës Nr. 19, datë 05.03.2019 të A. Z. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Përsa më lart, me anë të shkresës Nr. 353/2 prot., datë 11.03.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar Bashkisë Tiranë, ku i ka kërkuar informacion dhe parashtrime rreth ankesës së paraqitur nga ana e A. Z.
- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me anë të shkresës³ Nr. 11594/1 prot., datë 08.04.2019, Bashkia Tiranë, ndër të tjera ka informuar Komisionerin se: “Në mbështetje të nenit 64, shkronja “e” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Kryetari i Bashkisë emëron dhe i shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësisive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil. Gjithashtu, sipas Kreut XIV “Përfundimi i marrëdhënies së punës”, neni 153, pika 1, e Kodit të Punës, për shkaqe të justifikuara që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit vijimin e marrëdhënieve të punës, përcaktohet përfundimi i mënjëhershëm i kontratës së punës nga punëdhënësi apo punëmarrësi në çdo kohë për shkaqe të justifikuara”. Në rrjedhim të sa mësipër, Bashkia Tiranë thekson se shkarkimi i A. Z. me detyrë Drejtor i Qendrës Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, është kryer në përmbushje të rregullave ligjore dhe parimit të mirëbesimit siç parashikohet në nenin 153, pikën 2, të Kodit të Punës, ku vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës. Po nëpërmjet kësaj shkrese Bashkia Tiranë informon KMD se çështja e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës me subjektin ankues është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe zgjidhja e saj është kompetencë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

³ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 353/3 prot., datë 09.04.2019

2. Me shkresën datë 18.04.2019 (protokolluar pranë KMD-së me Nr. 353/4, datë 18.04.2019), subjekti ankues citon se: *“Bashkia e Tiranës mban qëndrim tjetër ndaj punonjësve të saj që janë anëtarë të Partisë Socialiste, kur ata marrin pjesë në aktivitete politike dhe nuk i largon nga puna. Ky është një fakt i bërë publik përmes postimeve të fotove që këta punonjës kanë bërë në rrjetet sociale, në aktivitetin e organizuar nga Partia Socialiste në Sheshin “Nënë Tereza” në Tiranë, me datë 23 Mars 2019”.*

Bashkëngjitur shkresës së mësipërme, ankuesja ka paraqitur disa foto ilustruese ku punonjës të Bashkisë Tiranë kanë marrë pjesë në aktivitete të organizuara nga subjekti politik Partia Socialiste, ku evidentohen shtetasit: A. S. me detyrë Nën/Kryetar i Bashkisë Tiranë, T. T. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Punëve Publike, T. J. me detyrë Administratore e Njësisë Bashkiake nr. 1, Tiranë, F. P. me detyrë Administrator i Njësisë Bashkiake nr. 2, Tiranë, A. B. me detyrë Drejtor Drejtorie dhe V. S. me detyrë këshilltare pranë Bashkisë Tiranë.

Në tjetër argument i vënë në dispozicion të KMD-së nga ana e ankuses, është fakti që ajo ka marrë dijeni nga mediat për largimin nga detyra për shkak të pjesëmarrjes në protestën e zhvilluar më datë 16.02.2019. Në mbështetje të këtij argumenti ankuesja ka vënë në dispozicion të KMD-së përgjigjet e përcjella nga shtetasit E. P. me detyrë Kryeredaktor i gazetës MAPO dhe E. D., me detyrë përfaqësues i portalit on-line 27.al, të cilët kanë sqaruar se informacioni për largimin e saj nga detyra u është bërë me dije nga burime zyrtare të Bashkisë Tiranë.

3. Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën Nr. 353/5 prot., datë 14.05.2019, njoftoi zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 22.05.2019 duke kërkuar shpjegime dhe informacion i cili do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Referuar njoftimeve të realizuara për zhvillimin e seancës dëgjimore, Bashkia Tiranë me anë të shkresës⁴ Nr. 20193/1 prot., datë 21.05.2019, informoi se nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është njoftuar lidhur me faktin e të qenit palë e paditur nga ana e A. Z. dhe zgjidhja e kësaj mosmarrëveshje është kompetencë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për këtë arsye nuk do të paraqitej në seancën e njoftuar nga KMD. Në këto kushte, seanca u zhvillua vetëm në praninë e palës ankuese, A. Z. dhe përfaqësuesit ligjor të saj, A. S.

Gjatë seancës dëgjimore, pala ankuese i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, si dhe shtoi se ajo ka qënë drejtuese e Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, gjatë viteve 2014-2017, e më pas asetet e kësaj qendre i kishin kaluar Qendrës Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”, në të cilën është rikthyer po në pozicionin e drejtueses së qendrës. Gjatë periudhës së punës pranë Qendrës Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”, ankuesja sqaron se ka marrë përgëzime nga drejtuesit e saj për punën e realizuar.

⁴ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 788/1 prot., datë 23.05.2019

4. Në vijim të procedurës së shqyrtimit të ankesës KMD me anë të shkresës Nr. 788 prot., datë 23.05.2019, kërkoi nga ana e Bashkisë Tiranë informacione dhe argumenta shtesë lidhur me largimin e A. Z. nga pozicioni i punës.
 - Bashkia Tiranë me anë të shkresës⁵ Nr. 21614/1 prot., datë 28.05.2019, parashtroi të njëjtat argumenta duke informuar se nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është njoftuar lidhur me faktin e të qenit palë e paditur nga ana e A. Z. dhe zgjidhja e kësaj mosmarrëveshje është kompetencë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
5. Në vijim të procedurës hetimore për marrjen e çdo prove dhe informacioni që i shërben procesit, A. Z., vuri në dispozicion të KMD-së, argumenta dhe prova shtesë në mbështetje të pretendimeve të ngritura në ankesë.

Fillimisht ankuesja vuri në dispozicion të KMD-së komunikimet që ka patur me eproren e saj direkte, shtetasen A. R., me detyrë Drejtore e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale të Bashkisë Tiranë, në aplikacionin WhatsApp. Me anë të këtyre komunikimeve ankuesja kërkon të provojë faktin se:

- më datë 18.02.2019, kur ndërsa ishte jo vetëm nënshkruar, por edhe publikuar urdhëri i largimit të saj nga puna, ajo vijonte të ushtronte detyrën,
- eprori i saj direkt A. R., e cila gjatë gjithë datës 18.02.2019 ka biseduar me të për mbarëvajtjen e punës, gjithashtu nuk reflektohej të kishte asnjë dijeni lidhur me urdhërin e largimit nga detyra e ankuseses.
- vlerësimet e eprores për punën e përditshme kanë qënë shumë pozitive.

Në vijim të informacionit të sipërcituar, ndër te tjera ankuesja depozitoi shkresat e emërimit të saj në Qendrën Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, më datë 30.05.2012 dhe kërkesën për largimin me dëshirë nga detyra në datën 05.02.2016. Gjithashtu, depozitoi urdhërat e largimit nga puna të Nënkryetares së Bashkisë Tiranë, K. M., si dhe Drejtorit të Tregjeve, S. H., të cilët kanë numra protokolli të njëpasnjëshëm dhe të lëshuar në të njëjtën datë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Mbështetur në aktet e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezulton se subjekti ankues, me Urdhërin Nr. 443, datë 30.05.2012, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, është emëruar në detyrën e Drejtorit të Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët”. Këtë pozicion

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 819 prot., datë 29.05.2019

ankuesja e ka mbajtur deri më datë 18.02.2016, kur kërkesa e saj për largimin nga detyra, është miratuar nga ana e Kryetarit të Bashkisë Tiranë me Urdhërin Nr. 3858/1, datë 18.02.2016. Me Urdhërin Nr. 5160, datë 31.01.2019, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ankuesja është rikthyer në pozicionin e Drejtorit të Qendrës Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë.

Më datë 16.02.2019, ditë e shtunë, kur ankuesja ka qënë në pushim zyrtar, ka marrë pjesë së bashku me Nënkryetaren e Bashkisë Tiranë, K. M. dhe Drejtorin e Tregjeve, S. H., në protestën e organizuar nga ana e opozitës, si anëtare e subjektit politik, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU).

Më datë 18.02.2019, dy ditë pas zhvillimit të protestës, në portalin Boldnews.al është publikuar artikulli me titull *“Ekskluzive/Lali Eri mbështet protestën e opozitës, zyrtarët e tij në protestë”*, me anë të të cilit komentohej se kryetari i Bashkisë Tiranë kishte mbështetur protestën kundër qeverisë duke sjellë si argument pjesëmarrje e punonjësve të Bashkisë Tiranë, anëtarë të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet. Ndër të tjera në këtë artikull citohej se: *“...Në protestën masive të thirrur nga opozita më 16 shkurt, në ballë të një grupi të përfaqësuesve të PDIU-së ishte kryetari Shpëtim Idrizi, ndërsa më pas krahët e ngrohtë ia mbante nënkryetarja e Bashkisë Tiranë, K. M. dhe drejtori i tregjeve në kryeqytet S. H....”*. Gjithashtu, bashkë me artikullin janë publikuar edhe 5 foto, ku në njërin prej tyre shfaqet edhe ankuesja, A. Z.

Po më datë 18.02.2019, media Panorama Online, ka publikuar artikullin me titull *“Jam qytetare e lirë’, nënkryetarja e shkarkuar e Bashkisë reagon pas vendimit të Veliajt: E nderuar që...”*, në të ndër të tjera citohej se: *“Tjetër e shkarkuar është edhe A. Z. drejtor i qendrës komunitare ‘Gonxhe Bojaxhi’*. Gjithashtu edhe media online dosja.al dhe 27.al , kanë cituar largimin e punonjësve të Bashkisë Tiranë të cilët janë larguar nga detyrat që mbanin në Bashkisë Tiranë, për shkak të pjesëmarrjes në protestën e datës 16.02.2019.

Sipas provave të administruara, ankuesja më datë 18.02.2019 dhe 19.02.2019 ka vijuar ushtrimin e detyrës së saj gjatë të gjithë orarit zyrtar të punës, duke komunikuar normalisht me eprorin direkt, A. R., nëpërmjet aplikacionit mobile WhatsApp, si dhe duke marrë përgëzime për punën e kryer. Më datë 19.02.2019, ankuesja ka marrë takim me K. L., e cila mban pozicionin e Drejtores së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Tiranë, nga e cila është vënë në dijeni, të largimit nga puna. Në këtë kuptim i është vënë në dispozicion Urdhëri Nr. 8151, datë 18.02.2019, për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Referuar provave të administruara gjatë procedurës hetimore, janë evidentuar raste ku punonjës të Bashkisë Tiranë, të cilët mbajnë pozicione drejtues, si p.sh.: E. K., me detyrë Drejtor i Drejtorisë e Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, A. S. me detyrë Nën/Kryetar i Bashkisë Tiranë, T. T. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Punëve Publike, T. J. me detyrë Administratore e Njesisë Bashkiake nr. 1, Tiranë, F. P. me detyrë Administrator i Njesisë Bashkiake nr. 2, Tiranë, A. B. me detyrë Drejtor Drejtorie dhe V. S. me detyrë këshilltare, kanë marrë pjesë në aktivitete politike. Në rastet e sipërcituara, ndaj

punonjësve që kanë marrë pjesë në aktivitete politike, Bashkia e Tiranës nuk rezulton të ketë mbajtur të njëjtin qëndrim me ankuesen.

Në këtë kontekst, referuar parashikimeve të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, (neni 59, gërma g) dhe Rregullores së Bashkisë “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë së Tiranës” (neni 30.2, pika g), të ndryshuar, Kryetari i Bashkisë emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësite në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil.

Referuar Urdhërit Nr. 8151, datë 18.02.2019, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë apo përgjigjeve të vëna në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë procedurës hetimore, ankueses nuk i është bërë me dije lidhur me arsyet e largimit nga puna. Mbështetur në shkresën Nr. 11594/1 prot., datë 08.04.2019, të Bashkisë Tiranë, konstatohet se largimi i saj nga detyra është bërë duke iu referuar nenit 153, pika 1, të Kodit të Punës. Pra, sipas pretendimit të Bashkisë Tiranë, largimi i ankueses nga detyra është bërë për shkaqe të justifikuara që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit vijimin e marrëdhënieve të punës.

Në interpretim të dispozitave⁶ të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, punëdhënësi mund të zgjidh kontratën e punës në çdo kohë, por për këtë duhet të ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dhe argumenta që justifikojnë zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Nisur nga interpretimet e bëra nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lart, në Vendimin Nr. 19, datë 15.11.2007, rezulton se, barra e provës për të justifikuar zgjidhjen e kontratës së punës i ngarkohet palës punëdhënëse vetëm në rastet e zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës (nenet 153-155 të Kodit të Punës).

Mbështetur në provat dhe informacionin e administruar, gjatë periudhës që ankuesja ka ushtruar detyrën pranë Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët” apo Qendrës Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”, nuk është marrë asnjë masë disiplinore ndaj saj. Gjithashtu, nuk rezulton e provuar se gjatë kësaj periudhe kohore që ka punuar në Bashkinë Tiranë të ketë patur rrethana të cilat çënojnë vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës.

Pavarësisht faktit që nga ana e këtij institucioni, në referim parashikimeve të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, mund të jenë respektuar procedurat dhe afatet e njoftimit për largimin nga puna, punëdhënësi në këtë rast

⁶ Neni 143, pika 1, ku parashikohet se: “Pas kohës së marrjes në provë, për të zgjidhur kontratën me periudhë të pacaktuar, palët duhet të respektojnë një afat njoftimi prej një muaji, gjatë vitit të parë të punës, prej dy muajsh për dy deri në pesë vjet pune, prej tre muajsh për më shumë se pesë vjet pune”.

Neni 153, ku përcaktohet se: “1) Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara.

2) Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t’i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

3) Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit.”faj të rëndë, si edhe rastet kur

nuk ka bërë me dije ankuesen për ekzistencën e shkaqeve të arsyeshme që justifikojnë zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Megjithëse nga ana Bashkisë Tiranë është pretenduar se ankuesja është larguar nga puna për shkak të humbjes së besimit, si rrethanë e rëndë për vijimin e marrëdhënieve të punës, Komisioneri vlerëson se këto argumentime nuk qëndrojnë, pasi nuk janë të mbështetura në asnjë nga provat dhe informacionet e vëna në dispozicion nga palët.

Për sa më lart, Komisioneri duke mos gjetur shkak të ligjshëm për largimin e ankueses nga puna konstaton se ajo është trajtuar në mënyrë të pafavorshme krahasuar me punonjës të tjerë të Bashkisë Tiranë dhe se masa e marrë për largimin e saj nga puna është e pajustificuar dhe e pa argumentuar ligjërisht.

Referuar nenit 7, pika 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se ankuesja A. Z. është ekspozuar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të disfavorshëm, nga ana e Bashkisë Tiranë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁷ të ligjit Nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Ankuesja pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe të pabarabartë, nga ana e Bashkisë Tiranë për shkak të *bindjeve politike*, shkak i parashikuar në nenin 1 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

“*Bindja Politike*” është shkak, për të cilin Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin

⁷ Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Gjatë trajtimit të ankesës së A. Z., u administruan prova se ankuesja është anëtare subjektit politik Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet.

C. Lidhja e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Tiranë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkaqeve të pretenduara nga ankuesi, sipas parashikimeve të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁸ dhe trajtimit të pafavorshëm të saj.

Sipas të dhënave zyrtare të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet vendore të vitit 2015 Partia Socialiste (PS) (anëtar i së cilës është edhe Kryetari i Bashkisë Tiranë) dhe PDIU-ja kanë garuar së bashku në koalicionin “Aleanca për Shqipërinë Europiane”. Strukturat e subjektit PDIU (Këshilli Kombëtar i kësaj force politike) kanë zyrtarizuar daljen nga koalicioni qeverisës (me datë 10.09.2018), ku bën pjesë partia kryesore PS-ja, anëtar i së cilës është edhe Kryetari i Bashkisë Tiranë, ky akt, ka zyrtarizuar daljen e subjektit PDIU në opozitë.

Për faktet që janë të njohura publikisht, bazuar në nenin 80/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sanksionohet se : *"Për faktet të cilat janë të njohura publikisht, si dhe për ato fakte të cilat janë të ditura për organin administrativ për shkak të funksioneve të tij, nuk nevojitet verifikim "*, nuk lind nevoja për verifikim.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia Tiranë:

- gjatë periudhës që ankuesja ka ushtruar detyrën pranë Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët” apo Qendrës Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”, nuk është marrë asnjë masë disiplinore ndaj saj. Gjithashtu, nuk rezultoi se gjatë kësaj periudhe kohore

⁸ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

që ka punuar në Bashkinë Tiranë të ketë patur rrethana të cilat çenojnë vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës.

- ndaj punonjësve që kanë marrë pjesë në aktivitete politike të organizuara nga subjekti Partia Socialiste, Bashkia e Tiranës nuk rezultojnë të ketë mbajtur të njëjtin qëndrim me ankuesen.
- procedura e largimit nga detyra e ankueses ka nisur menjëherë pas pjesëmarrjes në protestën e mbajtur nga opozita, ku edhe subjekti politik në të cilin aderon ankuesja.

Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit, nuk u sollën argumenta ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankueses se largimi i saj nga puna, nuk ka ardhur si pasojë e bindjes së saj politike.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, si dhe Kodi i Punës në ndryshimet e bëra, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkia Tiranë. Pra, në këtë rast Bashkia Tiranë, duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”.* Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Neni 47 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: *“1. Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar. 2. Tubimet paqësore në shesh dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj.”*

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive

themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njih dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokollin 12 i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.⁹

Duke iu referuar çështjes Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar, i cili ishte ankuar se shkakimi i tij nga detyra ishte i motivuar për shkak të bindjeve të tij politike, GJEDNJ-ja¹⁰ është shprehur se: “...në mungesë të masave mbrojtëse, një sistem ligjor që lejon shkakimin e punonjësit për shkak të anëtarësisë të punonjësit në një parti politike bart në vetvehte rrezikun potencial për abuzim të mundshëm.”. GJEDNJ theksoi gjithashtu se e drejta e ankuesit për të kundërshtuar largimin e tij nga puna është e vlefshme, pavarësisht bindjeve të tij politike, duke cituar se kjo vjen nga mbrojtja dhe garancia që ofron Neni 11 i Konventës¹¹.

Po ashtu, në “Kartën Sociale Europiane” të rishikuar¹², dhe shtojcën e saj, në nenin 24, pika 3, germa d) parashikohet se: “...Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit:... d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare, përgjegjësitë familjare, shtatzania, besimi fetar, **opinionit politik**, prejardhja kombëtare ose origjina sociale”.

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: “Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”. Ndërsa pika 5, germa c) e tij parashikon se: “Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:...c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”.

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së¹³. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu në nenin 12 të ligjit 10221/2010 parashikohet se ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1.

⁹ https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_law_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49.

¹⁰ Shkurtesë për Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

¹¹ “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij. 2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore”.

¹² “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr.8960, datë 24.10.2002.

¹³ Referuar nenit 3, pika 8 ,e LMD-së.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

E drejta për të shprehur mendimet dhe bindjet politike, sidomos në forma qytetare nëpërmjet tubimeve, është një e drejtë kushtetuese dhe liria për të marrë pjesë është e garantuar. Punonjësit e administratës nuk mund të ushtrojnë të drejtat e tyre politike kur ata janë duke kryer shërbimin e tyre publik. Rrjedhimisht, në kushtet kur tubimi ka qenë i organizuar ditën e shtunë, pra në një ditë pushimi, ankuesja ka qenë krejtësisht e lirë për të shprehur bindjet e saj politike pa pasur asnjë lloj pasojë negative për ushtrimin e lirisë së saj.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se A. Z., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Bashkisë Tiranë, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankueses dhe pjesëmarrjen e saj në protestën e opozitës më datë 16.02.2019.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasës A. Z. nga ana e Bashkisë Tiranë për shkak të bindjeve politike.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Robert GAJDA

KOMISIONER

(Shkaku: Bindja Politike)

(Fusha: Punësim)